

VENDIM
Nr. 253, datë 10.4.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 45, DATË 22.1.2025, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN
USHTARAK ‘INTERFLEX’ NË MBRETËRINË E BASHKUAR TË BRITANISË SË
MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 45, datë 22.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ‘Interflex’ në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, togfjalëshi “... 8 (tetë) ushtarakëve ...” zëvendësohet me “... 12 (dymbëdhjetë) ushtarakëve ...”;

b) Në pikën 4, fjalët “Kohëzgjatja e këtij misioni është 1 vit ...” zëvendësohen me “Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 28.2.2027 ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama